



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 708/ 6 prot.

Datë 27.03.2025

V E N D I M
Nr. 415/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.O.O në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-34932-12-30-2024, me objekt: “*Implementimi i Smart Solution LoRaËAN ne infrastrukturen naftenxjere se te Albpetrol sh.a. per periudhe 2 vjecare*”, me fond limit 78,804,667 (shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 806,021 (tetëqind e gjashtë mijë e njëzet e një) Euro pa tvsh me kursin e kembimit te dates 30.12.2024, zhvilluar më datë 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.O.O, me NIPT L02409020R, me adresë Rruga “Reshit Collaku”, Pallati Aurora Construction, Nr. 1, Kati. 4, Ap. 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Albpetrol sh.a.
Adresa: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34932-12-30-2024, me objekt: “Implementimi i Smart Solution LoRaËAN ne infrastrukturen naftenxjeresë të Albpetrol sh.a. për periudhë 2 vjetore”, me fond limit 78,804,667 (shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 806,021 (tetëqind e gjashtë mijë e njëzet e një) Euro pa tvsh me kursin e kembimit të datës 30.12.2024, zhvilluar më datë 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

II.2. Në datën 10.02.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 28.02.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "ALCom Solutions" SHPK	66,983,967	lekë skualifikuar
2. BOE "Verso" SHPK & "Verso Altima" D.O.O	75,858,000	lekë skualifikuar
3. "Global Business Solutions" SHPK	76,046,504	lekë skualifikuar
4. "AMG Energy Albania" SHPK	76,440,526	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 28.02.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Verso" SHPK & "Verso Altima" D.O.O është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

1- Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 9, BOE nuk ka paraqitur punonjës të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë certifikimet:

- 2 (dy) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
- 1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve.

konkretisht:

- Josko Udiljak
- Nenad Kopic
- Ivan Grgosevic
- Andrija Gebert

Nuk janë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente

Në zbatim të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 88 I kësaj VKM-je, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1, 2 dhe 3, kërkohet qartësisht që: "1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje."

Në Kontratën e Bashkepunimit të datës 27.01.2028, palet kontraktuese “VERSO SHPK” dhe “VERSO ALTIMA D, O, O”, kanë vendosur midis tyre se: “Shoqëria “VERSO SHPK” do të kontribuojë në masën 63.9 % në këtë pjesëmarrje dhe Shoqëria “VERSO ALTIMA D. O.O” do të kontribuojë në masën 36.1 % në këtë pjesëmarrje”.

Referuar bazës ligjore të sipërpërmendur dhe Kontratës së Bashkepunimit që ky BOE ka hartuar, kërkesat profesionale sipas DST-së, nuk përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, konkretisht:

OE “VERSO” shpk, me kontribut 63.9 %, deklaroi disponimin e vetëm 1 punonjësi (Sokol Bani), të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, i cili plotëson kërkesën për certifikime profesionale: -1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë OE “VERSO ALTIMA D.O.O.”, me kontribut 36.1 % deklaroi disponimin 6 punonjësve të tjerë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, plotësojnë kërkesën për certifikime profesionale:

- 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel experti ne rrjeta dhe siguri

- 4 (kater) punonjës të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaEÄAN, Cisco ose ekuivalente.

II.5. Në datën 03.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Anulimit” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 12.03.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5132, dhe nr. 708/2025 prot, datë 13.03.2025 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.O.O, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë vijon:

Refuzimin e ofertës se BOE është i pa drejte dhe i pa mbështetur ligjërisht pasi Autoriteti kontraktor, ne shtojcën 9 të DST-ve të këtij tenderi, Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, tek KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT, pika 1/a AK ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në shtojcën 9 Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5., AK ka parashikuar plotësimin e kriterit si vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve hardëare dhe softëare objekt-kontratë, duhet të disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës, të diplomuar në një nga porfilet e IT, ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për Áertifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë

- 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel experti ne rrjeta dhe siguri

- 4 (katër) punonjës të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete loraan, Cisco ose ekuivalente.
- 2 (dy) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve.

Shënim: një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentet në origjinal ose kopje të noterizuara për punonjësit e mësipërm, dokumentacionin si me poshtë vijon:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë e arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha degët e informatikës, shkencave kompjuterike, teknologjisë së informacionit, ose ekuivalente.
- Certifikatat/Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituara nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës, për secilin specialist të kualifikuar.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit në të cilat stafi i siperpermendur duhet të figurojë.

Gjithashtu në proces verbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim të publikuar në SPE, AK lidhur me vendosjen e kriterit 2.3.5 ka argumentuar si vijon:...

Argumentimi: kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve objekt-prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i diplomuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomikë ofertues. Këto janë dokumenta provuese që i shërbejnë Autoritetit Kontraktor që punonjësit e deklaruar nga operatori ekonomik disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Bazuar sa më sipër, në përmbushje të kriterit të sipërcituar secili prej operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në këtë bashkim ka dorëzuar në SPE:

1. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9), të plotësuar nga secili prej tyre, ku në deklaratën për disponimin e punonjësve dhe mjeteve, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat a, b, d, dh, e, h, i, j të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të kështillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar

në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Operatori ekonomik “Verso” Shpk ka deklaruar 10 punonjes kryesisht te profileve Ing. IT, rrjeti, konkretisht si vijon:

Ndersa operatori ekonomik “Verso Altima” d.o.o, ka deklaruar 133 punonjes ne profile IT, finance, marketing, etj konkretisht si vijon:

Sa me siper, refuzimi i ofertes se bashkimit te OE nga AK me argumentin se në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca 9, BOE nuk ka paraqitur punonjës të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë certifikimet:

2 (dy) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve.

Konkretisht:

- Josko Udiljak*
- Nenad Kopic*
- Ivan Grgosevic*
- Andrija Gebert*

Nuk janë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente

Nuk qëndron dhe eshte i pa mbeshtetur, pasi Ak ka kërkuar disponimin e 12 punonjesve ne profile IT ose ekuivalent, ku secili prej anëtarëve të këtij bashkimi ka deklaruar disponimin e punonjësve sipas numrit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit kriteri 2.3.5, si dhe ka evidentuar punonjesit e certifikuar, duke evidentuar dhe certifikimet perkatese te tyre, konkretisht:

OE “Verso” SHPK ka deklaruar se disponon 10 punonjes, me profil ing IT, rrjeti, etj si dhe Z. Sokol Bami, diplomuar ne Universitetin e Tiranës per informatike date 29.06.2006, te certifikuar ne nivel profesional Certified Eëireless Netëork Professionals (CËNP) per projektimin e rrjetave me vale me ID nr. 824690, ne reference te kerkeses se AK pika 2.3.1, paragrafi i pare dhe zërave qe ka merre përsipër ne kontratën e bashkëpunimit.

OE Verso Altima D.o.o ka deklaruar 133 punonjes, ne profile IT, etj, dhe stafin teknik te certifikuar me certifikimet e kërkuara (ref formularit sipërcituar) ose ekuivalente.

Ne lidhje me punonjesit e siper permendur nga Autoriteti Kontraktues se nuk jane te diplomuar ne nje nga profilet IT ose ekuivalente, theksojme se edhe pse tituli i diplomave te tyre nuk e shpreh specifikisht teknologjine e informacionit, ata te katert e kane titullin inxhiner me baze ne teknologjine e informacionit si dhe njohurit e thelluara ne kete fushe bazuar kjo ne kurrikulat e tyre te diplomes, si dhe nga certifikimet e ndryshme te listuara nga OE ne formularin e vete deklarimit lidhur e certifikimet e kerkuara. Teknologjine e informacionit, me specifikisht:

Z. Josko Udiljak ka kryer bazen e informatikes perفشire ketu lende si programim, strukture te dhenash, algoritmik, analize te dhenash, akitekture kompiuterike, baza te dhenash, rrejtja kompiuterike, programim bazuar ne objekte, (object oriented programming) ne C++, analize matematike, algjeber, bioinformatik, statistik, fizik, etj .(per me shume referojuni dhe link-ut te universitetit

https://www.pmf.unizg.hr/math/en/study_programmes/undergraduate_university_programme_in_mathematics_per_curriculen_e_plote_te_kursit).

Z. Ivan Grgosevic me titullin inxhinier, ka nje diplom multidisiplinare ne inxhinjeri ushtrie. Programi i inxhinierise Ushtarake ne Universitetin e Zagrebit eshte nje program studimi universitar i akredituar, i krijuar per te pajisur studentet me njohuri, aftesi dhe kompetenca me standardet nderkombetare dhe ato te NATO-s. Kurrikula perfshin si edukimin teknik, ashtu edhe trajnimin e plotë ushtarak, duke i pergatitur te diplomuarit per role brenda Forcave te Armatosura Kroate si dhe sektorin privat. (burimi: <https://vojni.unizg.hr/en/sp/me>). Ne Kroaci, njohja e kualifikimeve arsimore, vecanerisht per qellime punesimi, rregullohet nga Akti per Njohjen e Kualifikimeve Arsimore te Huaja. Ky akt siguron qe kualifikimet e marra nga institucionet e akredituara te jene te vlefshme ligjesisht per perdorim profesional brenda vendit. (burimi: <https://gov.hr/en/recognition-of-education-qualifications-from-other-countries/1076>). Duke qene se programi i inxhinierise Ushtarake eshte i akredituar dhe zhvillohet ne bashkepunim me akademine e Mbrojtjes Kroate Dr. Franjo Tudman, ai ploteson standardet kombetare per arsimin e larte. Si rrjedhoje, te diplomuarit e ketij programi kane nje formim arsimor te njohur ligjesisht, i cili eshte i rendesishem per profesionet qe lidhen me inxhinierine ushtarake dhe fushat perkatese ne Kroaci, perfshire ketu dhe teknologjine e informacionit ne ushtri. (burimi: <https://gov.hr/en/military-university-study-programmes/1074>). Gjithashtu, referuar kurikules se tij, bejme me dije se ajo permban lendet baze te teknologjise se informacionit si algjeber, Sisteme informacioni dhe komunikimi, Calculus, sistemet dhe teknologjite e mbrojtjes, etj. (per me shume referojuni dhe link-ut https://vojni.unizg.hr/en/sp/me/engineers_per_curriculen_e_plote_te_kursit).

Z. Andrija Gebert ka nje diplome inxhinieri me profil elektornik dhe automatizim, e cila permban lende te lidhura me teknologjine e informacionit dhe informatiken si programim, elektronik, rrjeta komunikimi, Probabilitet dhe statistik, Teknologji informacioni dhe komunikimi, etj (per me shume referojuni dhe link-ut https://www.ferit.unios.hr/study-programmes/undergraduate-university-study#branch-electrical-engineering_per_curriculen_e_plote_te_kursit).

Z. Nenad Kopic, inxhinier mekanik ne universitetin e zagrebit, ka kryer lende baze te teknologjise se informacionit duke perfshire Matematike, Teknologji, Dizajnim kompjuterash, Dizajnimi i elementve mekanik, Analize vektoresh, programim microcontroller, etj, te cilat gjithashtu lidhen drejperdrejt me sensoret qe BOE ka ofertuar (per me shume referojuni dhe link-ut

https://www.fsb.unizg.hr/index.php?Fsbonline&departments&industrial_engineering&lang=en per curriculen e plote te kursit).

Sjelli ne vemendje se AK ka kerkuar 2 (dy) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, ndërsa bashkimi i OE ka deklaruar si staf te tille teknik te certifikuar ne kete fushe tre specialista konkretisht, Andrija Gebert, Ivan Grgossevic dhe Nenad Kopic, te cilët janë të diplomuar në një nga porfilet e IT, ose ekuivalente.

Vete AK ne procesverbalin e argumentimit te ketij krireri ka cituar: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve objekt-prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i diplomuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomikë ofertues. Këto janë dokumenta provuese që i shërbejnë Autoritetit Kontraktor që punonjësit e deklaruar nga operatori ekonomik disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Referuar kriterit të sipërcituar, dhe nenit 26 të VKM 285, dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar disponimin e numrit të punonjësve dhe profileve në përputhje me kriterin e kualifikimit, duke përmbushur në këtë mënyrë si numrin e punonjësve të stafit teknik ashtu dhe profilet e tyre.

Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për këtë arsye, për sa kohë, nga vetë autoriteti kontraktor është specifikuar në dokumentet standarde të tenderit, se ky kriter do të quhet i përmbushur me dorëzimin e shtojcës 9, pra formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe akoma më tej nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj dhe VKM si më sipër cituar, atëherë skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

B) Lidhur me arsyen e dyte te refuzimit se me argumentin se.... Referuar bazës ligjore të sipërpërmendur dhe kontratës së bashkëpunimit që ky BOE ka hartuar, kërkesat profesionale sipas DST-së, nuk përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrë. Në pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, konkretisht:

OE “VERSO” shpk, me kontribut 63.9 %, deklaroi disponimin e vetëm 1 punonjësi (Sokol Bani), të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, i cili plotëson kërkesën për certifikime profesionale:

-1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë OE “Verso Altima” D.O.O me kontribut 36.1 % deklararon disponimin 6 punonjësve të tjerë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, plotësojnë kërkesën për certifikime profesionale:

- 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel experti në rrjete dhe siguri

- 4 (kater) punonjës të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete loraëan, Cisco ose ekuivalente.

Sa me sipër, kundërshtojmë duke sjelle në vëmendje se BOE ka dorezuar Kontraten e bashkepunimit ndërmjet paleve ku OE “Verso” shpk, ka deklaruar se merr përsipër, 63.9 % nga të cilat rreth 31 % e totalit të zërave/vlerës (zëri 5 dhe 7), është për blerje licensash dhe ka të bëjmë vetëm me lëvrimin e aksesit në platformat inteligjente nga prodhuesi, ndërsa “Verso Altima” d.o.o ka deklaruar se merr përsipër 36.1 %, konkretisht zërat si vijon:

Theksojmë se nga ana e autoritetit kontraktor, në total për realizimin e kësaj kontrate janë kërkuar 12 punonjës të profileve të ndryshme inxhinierike ose ekuivalente, nga ky numër total punonjësish operatori ekonomik ankimues kryesues Verso Sh.p.k. Vertëton nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit se disponon 10 punonjës, ndërsa Verso Altima d.o.o 133 punonjës.

Pra referuar nenit 88 , pika 1 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet se: Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një Kontrate Bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve dhe Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në këtë rast, referuar kontributit në total në pjesëmarrje të deklaruar në kontratën e bashkepunimit të operatorit ekonomik ankimues kryesues “Verso” SHPK, se disponon 10 punonjës në IT, rrjetë, zërave konkrete të marre përsipër në kontratën e bashkepunimit, arrin të plotësojë dhe tejkalon % e kërkesave të autoritetit kontraktor në lidhje me fuqinë punëtore të kërkuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

Bazuar preventivit të marre përsipër për zërat 3, 4 6 8 dhe 9 në kontratën e bashkepunimit nga ana e Verso sh.p.k. Si dhe deklarimit në formularin e vetë deklarimit, veme në dukje se Punonjësi i deklaruar i certifikuar si Certified Eireless IoT Design Professional (CËIDP) posedon njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të identifikuar, dizajnuar, instaluar dhe vlerësuar zgjidhjet iot me valë. Ky certifikim ofron njohuri të plota për të justifikuar aftësinë

profesionale të individit në kontekstin e një projektit specifik, duke përmbushur kërkesat teknike dhe rregullatore të përcaktuara nga AK. Bazuar në njohurit e fituara, një individ me certifikimin CĖIDP ka kompetencën për:

1. Analizën dhe vlerësimin e zgjidhjeve IoT - CĖIDP ka aftësinë për të vlerësuar zgjidhjet ekzistuese të IoT, duke garantuar që ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të komunikimit dhe sigurisë. Në bazë të Rregulloreve për Pajisjet IoT dhe sigurinë Kibernetike, çdo sistem IoT duhet të kalojë një fazë vlerësimi për të garantuar integritetin dhe funksionalitetin e tij.
2. Mbledhjen dhe përcaktimin e kërkesave - në përputhje me normat e inxhinierisë së sistemit, CĖIDP është i aftë të identifikojë kërkesat teknike dhe biznesore të një zgjidhjeje IoT me valë, duke siguruar që ato janë të mirëpërcaktuara për qëllime operationale dhe përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë.
3. Dizajnimin e Rrjeteve dhe infrastrukturës IoT - në përputhje me standardet e komunikimit pa tel (IEEE 802.11, LoRa, 5G, etj.), CĖIDP është i kualifikuar për të krijuar një arkitekturë të sigurt dhe të optimizuar për komunikimin IoT. Kjo përfshin zgjedhjen e topologjisë së përshtatshme, konfigurimin e kanaleve të frekuencave dhe krijimin e planeve të RF.
4. Sigurinë e Sistemeve IoT - në përputhje me rregulloret e sigurisë kibernetike dhe privatësisë së të dhënave, CĖIDP merr në konsideratë faktorët e sigurisë gjatë dizajnit dhe implementimit të një zgjidhjeje IoT me valë. Ai siguron që të gjitha sistemet janë të mbrojtura nga sulmet kibernetike dhe që respektohen protokollat e enkriptimit dhe kontrollit të aksesit.
5. Dokumentimin Teknik dhe Validimin e Zgjidhjes IoT - në përputhje me praktikat më të mira të dokumentimit dhe certifikimit të sistemeve (ISO/IEC 27001, ISO 9001), CĖIDP është i aftë të prodhojë dokumentacion të detajuar mbi dizajnin dhe konfigurimin e sistemit. Ky dokumentacion është thelbësor për auditimet teknike dhe për qëndrueshmërinë ligjore të projektit.
6. Optimizimin e performancës së Sistemeve IoT - CĖIDP mund të kryejë testime dhe optimizime të zgjidhjes IoT, duke ndjekur protokollat e vlerësimit të performancës së rrjeteve pa tel dhe duke siguruar që sistemi të jetë efikas dhe i qëndrueshëm për përdorim afatgjatë. Në përfundim, certifikimi CĖIDP i Sokol Bani i jep kompetencën teknike për të kontribuar në projektet që përfshijnë zgjidhje IoT me valë, duke respektuar kornizat rregullatore dhe standardet ndërkombëtare. Ky certifikim mund të përdoret si bazë për vërtetimin e aftësisë profesionale në projektet e lidhura me inxhinierinë e sistemit, komunikimet pa tel dhe sigurinë kibernetike, duke garantuar një zbatim të besueshëm dhe të sigurt të teknologjive IoT. Per me shume ref link; <https://ëëë.cënp.com/certifications/cëidp>.

Gjithshtu duam të vëmë në dukje se personeli i deklaruar i OE Verso Altim d.o.o, të cilët janë të certifikuar në nivel profesional dhe ekspert, si dhe bazuar në njohurit që kanë nga edukimi respektiv, janë të nevojshëm për të konfiguruar pajisjet inteligjente dhe mikrokontrollerat respektiv të tyre duke i konfiguruar dhe programuar ato, si pjesë e lëvrimit, instalimit dhe konfigurimit të sensorve inteligjent sipas zërave 1 dhe 2.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, theksojmë se nepermejt dokumentacioni të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes "Verso" sh.p.k. si operator kryesues në procedurën e prokurimit, i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i

vlefshëm, pasi nga 12 punonjës në total, të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit nga autoriteti kontraktor për realizimin e kontratës, operatori ekonomik kryesues ankimues “Verso” sh.p.k. disponon 10 punonjës në total më shumë se 80 % të stafit, sikurse përcaktohet dhe në nenin 88 pika 3 “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në aktmarrëveshje.

Gjithashtu, vlen të theksojmë, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në kriterin e vecantë të kualifikimit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, gjykojmë, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, theksojmë se dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimues në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë dhe se AK nuk ka bërë një hetim apo verifikim për punonjësit. Vlen të theksojmë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e kontratës se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Vete APP, ne rekomandimet e veta ndër të tjera ka theksuar se se: [...] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushen, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 9 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës imbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik disponon numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...]. Thekosjmë se ligjvënësi ka parashikuar dy momente të përcaktimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë. Momenti i parë lidhet me kriteret e kualifikimit, si përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësinë teknike dhe profesionale., në të cilat ligjvënësi i ka lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor për përcaktimin e tyre, diskrecion, i cili edhe në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të tejkalohet kufijtë e vendosur nga ligji dhe konkretisht, atë të vendosur në nenin 77 të ligjit Për Prokurimin Publik, pra të jenë në proporcion me natyrën, volumin dhe përmasat e kontratës, si edhe të mos jenë diskriminuese. Së dyti, është grupi i kriterëve të kualifikimit të cilat janë të shprehura qartësisht në ligj ose në akt nënligjor dhe që janë detyruese për të gjithë autoritetet kontraktore Pra, elementët që janë të domosdoshme për të përmbushur fazën e parë të vetëdeklarimit në drejtim të disponueshmërisë së stafit teknik në rastin konkret, është vetëm plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve

sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Si konkluzion dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i operatoreve ekonomik në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor referuar nenit 2, nenit 21 të LPP-së, është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, duke siguruar mirëpërdorim të fondeve publike, një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

Nepermjet dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi oferta e Bashkimit të Operatoreve “Verso” shpk (Perfaqesues) dhe “Verso Altima” d.o.o, me vlere oferte 75.858.000 leke eshte nje oferte e përgjegjshme/vlefshme pasi ajo i plotëson kërkesat e përcaktuara ne Dokumentat e Tenderit, pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, dhe nuk duhet të skualifikohet.

Për sa më sipër, duke qene se:

- Formulari i vetëdeklarimit është plotësuar në përputhje të plotë me atë cfarë është kërkuar në DT, i kërkojmë (KVO) të rivlerësojë ofertën tonë duke vlerësuar se ajo është në përputhje me atë cfarë është kërkuar në DT.

Për sa kemi argumentuar me sipër, referuar ligjit të prokurimit publik, akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe referuar kritereve ne DT, i kërkojmë AK, Albpetrol sh.a që:

Të shfuqizojë vendimin e Komisionit të Vleresimit të Ofertave si nje vendim antiligjor.

Të kualifikojë ofertën e Bashkimit të operatoreve ekonomik “Verso” Shpk (Perfaqesues) dhe “Verso Altima” d.o.o (I perfaqesuar), me vlere oferte 75 858 000 leke.

Theksojme se, argumentat e trajtuara me sipër jane te bazuar ne ligj dhe ne prova sipas dokumentacionit të ofertes te dorezuar ne SPE. Nëse AK, KSHA si dhe KPP do te ketë nevojë të verifikoje dokumentacionin në forme shkresore që disponoj jam i gatshëm të bashkëpunojë në cdo kohë duke jua vënë në dispozicion ato.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 708/1 prot., datë 13.03.2025, me arsyet e skualifikimit që bashkimi operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” d.o.o kundërshton me anë të ankesës me nr. 708/2025 prot, datë 13.03.2025.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1397/1 prot., datë 18.03.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 708/2 prot., datë 18.03.2025 me objekt “Vendim për Shqyrtim Ankesë”, (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), si dhe shkresës nr. 1397/4 prot, datë 18.03.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 708/3 prot, datë 21.03.2025 me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik Verso shpk” është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 1397/3 prot, datë 18.03.2025 autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës mos pranimit e saj me argumentat si vijon:

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA, per këte pike të ankesës, nga shqyrtimi i dosjes së tenderit dhe SPE, per sa i perket vleresimit te kesaj procedure, konstaton se refuzimi i ofertës së OE ankimues ka ardhur si rezultat i vlerësimit te kriterit 2.3.5., te ndyshuar me shtojcën ne DST të datës 23.01.2025, ku AK konkretisht kërkon që:

Operatori ekonomik pjesemarres, për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve hardëare dhe softëare objekt-kontratë, duhet te disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës, te diplomuar në një nga porfilet e IT, ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, te plotësojne kerkesat për çertifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes te çertifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë 2 (dy) punonjes të certifikuar në nivel experti ne rrjeta dhe siguri*
- 4 (katër) punonjës të çertifikuar ne nivel bazë/profesional për rrjete LoRaEÄN, Cisco ose ekuivalente.*
- 2 (dy) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit.*
- 1 (një) punonjes të çertifikuar në nivel profesional, per menaxhimin e projekteve.*

Shënim: Një punonjës mund te ketë një ose disa çertifikime.

Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mesipër, perpara publikimit te njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqese dokumentet në origjinal ose kopje të noterizuara për punonjësit e mësipërm, dokumentacionin si me poshte vijon:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.*
- Diplome e arsimit të lartë, duke përfshirë te gjitha degët e informatikes, shkencave kompjuterike, teknologjisë se informacionit, ose ekuivalente.*
- Certifikatat/Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuara nga organizma te akredituara nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjines, për secilin specialist te kualifikuar.*
- Listepagesat e shogerise per te pakten 3 (tre) muajt e fundit ne te cilat stafi i siperpermendur duhet te figuroje.*

Nga verifikimi i procesverbalit të vlerësimit të KVO, i datës 28.02.2025, konstatohet se skualifikimi i BOE për mospermbushjen e këtij kriteri është argumentuar nga KVO si më poshtë:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “VERSO” shpk me NUIS L02409020R dhe “VERSO ALTIMA” D.O.O, nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 9, BOE nuk ka paraqitur punonjës të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë certifikimet:

2 (dy) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve. konkretisht:

Josko Udiljak Nenad Kopic

Ivan Grgosevic

Andrija Gebert

Nuk janë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente.

Nga sa KVO konstaton, arsyetohet se ky skualifikim i BOE, ka ndodhur për shkak se punonjësit e deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit nga BOE, si punonjës të certifikuar me certifikimet e kerkuara, nuk janë të diplomuar në profilet IT ose ekuivalente. Sipas kërkesës së këtij kriteri është e gartë që punonjësit e paraqitur si të certifikuar domosdoshmerisht duhet të jenë të diplomuar si IT ose në degë ekuivalente. Nëse për një punonjës të caktuar deklarohet që është i diplomuar në degën e matematikës, inxhinierisë mekanike, apo asaj ushtarake, nuk do të konsiderohet ekuivalente me ndonjë nga degët e Teknologjisë së Informacionit. Për këtë arsye kriteri 2.3.5 është konsideruar si i paparaqitur. Nisur nga parashtrimet e ankimesit theksojmë se kriteri i vendosur, është për paraqitjen e diplomes në një nga fushat e IT ose ekuivalente, jo për lëndë të vecanta sic pretendon ankimesi. Nga shqyrtimi i procesit të vlerësimit nga KVO vihet re se është mbajtur i njëjti qëndrim dhe për OE të tjerë të skualifikuar duke e hedhur poshtë tezën e diskriminimit apo favorizimit nga momenti që kjo procedurë është anuluar për mos paraqitjen e asnjë oferte të përshtatshme.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit për këtë pikë nuk qëndron.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA, për këtë pikë të ankesës, nga shqyrtimi i dosjes së tenderit dhe SPE, për sa i përket vlerësimit të kësaj procedure, konstaton se OE skualifikohet për arsyet e mëposhtme: Në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 88 i kësaj VKM-je, “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 1, 2 dhe 3, kerkohet qartësisht që: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomike, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njeri prej të cileve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve

ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre perfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dergohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga perfaqësuesi. Perfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në Kontratën e Bashkëpunimit të datës 27.01.2028, palet kontraktuese “VERSO” SHPK dhe “VERSO ALTIMA” D.O.O, kanë vendosur midis tyre se: “Shoqëria “VERSO” SHPK do të kontribuojë në masën 63.9 % në këtë pjesëmarrje dhe shoqëria “VERSO ALTIMA” D.O.O do të kontribuojë në masën 36.1 % në këtë pjesëmarrje”. Referuar bazës ligjore të sipërpërmendur dhe Kontratës së Bashkëpunimit që ky BOE ka hartuar, kërkesat profesionale sipas DST-së, nuk përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje,

OE “VERSO” shpk, me kontribut 63.9 %, deklaroi disponimin e vetëm 1 punonjësi (Sokol Bani), të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, i cili plotëson kërkesën për certifikime profesionale:

-1 (një) punonjes të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë

OE “VERSO ALTIMA” D.O.O, me kontribut 36.1 % deklaroi disponimin 6 punonjësve të tjerë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, plotësojnë kërkesën për certifikime profesionale:

2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel experti në rrjete dhe siguri

4 (kater) punonjes të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaëAN, Cisco ose ekuivalente.

AK për këtë procedurë prokurimi në DST kërkon si më poshtë vijon:

Rezultatet që duhet të arrijë Operatori Ekonomik gjatë kësaj kontrate rënditen në vijim:

- Instalimin dhe konfigurimin e serverit të rrjetit;
- Instalimin dhe konfigurimin e sensorëve të vëllimit për matjen e nivelit të fluidit në depozitat në sektor ose grupe;
- Instalimi dhe konfigurimi i sensorëve të energjisë;
- Instalimin dhe konfigurimin e platformës smart për monitorimin e nivelit të naftës në depozita si dhe monitorimin e punës së puseve;
- Instalimi dhe rregullimi i rrjetit LoRaëAN (duke përfshirë antenat) për të siguruar mbulimin e plotë të zonës ku do të vendosen sensorët;
- Konfigurimi i hapësirave të ruajtjes, konfigurimi i rrjetit, virtualizimit dhe komponentet e tjerë thelbësorë;
- Konfigurimi i kontrollit të aksesit të bazuar në role (RBAC) dhe politikat e sigurisë;
- Testimi i infrastrukturës së implementuar bazuar në planin e dakordësuar të testimeve;
- Përgatitja e dokumentacionit mbi konfigurimet e kryera;
- Trajnimi për përdorimin e platformes inteligjente;
- Mirembajtja 24- mujore e sistemit inteligjent të monitorimit (pajisjet dhe aplikacionin);

Nepermjet kontratës së bashkëpunimit të BOE, secili nga anëtarët e këtij bashkimi deklaroi shërbimin që do të kryejë dhe konkretisht:

Shoqëria “VERSO” SHPK do të kontribuojë në masën 63.9 % në këtë pjesëmarrje duke marrë persipër të realizojë zërat konkretisht si vijon:

1. Antenat LoRaEan (Furnizim, Instalim)
2. Konfigurim i Platformës Inteligjente Smart
3. Licensat për Platformën Inteligjente/Smart (për 300 sensorë)
4. Konfigurimi i Platformës së Serverit të rrjetit
5. Licensat për Platformën e Serverit të rrjetit (për 10 antena)
6. Trajnim i përdoruesve të platformës
7. Mirëmbajtje

Shoqëria “VERSO ALTIMA” D. O.O do të kontribuojë në masën 36.1 % në këtë pjesëmarrje duke marrë persipër të realizojë zërat konkretisht si vijon:

1. Sensorë inteligjente të vëllimit (furnizim, instalim, konfigurim)
2. Pajisje inteligjente e menaxhimit të energjisë (furnizim, instalim dhe konfigurim)

Shoqëria “VERSO” SHPK deklaroi në formular vetëm - 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me vale (S.B.) sipas kërkesës së AK. Për sa më sipër arrihet në konkluzionin se shoqëria “VERSO” SHPK sipas deklaratimit të saj, nuk i ka kapacitetet profesionale për realizimin e kontratës sipas përqindjes dhe natyrës së mallit/shërbimit që ka marrë persipër të kryejë në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit për këtë pikë nuk qëndron.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 114 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 102 të vendimit nr. 285, të Këshillit të Ministrave, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, KSHA

Vendosi

1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga OE “Verso” SHPK.
2. Ky vendim i komunikohet Titullarit të AK.
3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimes dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” d.o.o se: “Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 9, BOE nuk ka paraqitur punonjës të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë certifikimet: - 2 (dy) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit. - 1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve konkretisht: - Josko Udiljak; - Nenad Kopic; - Ivan Grgosevic; - Andrija Gebert. Nuk janë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente. Në zbatim të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 88 I kësaj VKM-je, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1, 2 dhe 3, kërkohet qartësisht që: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në Kontratën e Bashkëpunimit të datës 27.01.2028, palet kontraktuese “VERSO SHPK” dhe “VERSO ALTIMA D. O. O”, kanë vendosur midis tyre se: “Shoqëria “VERSO SHPK” do të kontribuojë në masën 63.9 % në këtë pjesëmarrje dhe Shoqëria “VERSO ALTIMA D. O. O” do të kontribuojë në masën 36.1 % në këtë pjesëmarrje”. Referuar bazës ligjore të sipërpërmendur dhe Kontratës së Bashkëpunimit që ky BOE ka hartuar, kërkesat profesionale sipas DST-së, nuk përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, konkretisht: OE “VERSO” shpk, me kontribut 63.9 %, deklaron disponimin e vetëm 1 punonjësi (Sokol Bani), të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, i cili plotëson kërkesën për certifikime profesionale: -1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë OE “VERSO ALTIMA D.O.O.”, me kontribut 36.1 % deklaron disponimin 6 punonjësve të tjerë të diplomuar në një nga porfilet e IT ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, plotësojnë kërkesën për certifikime profesionale: - 2 (dy) punonjës të çertifikuar në nivel experti në rrjeta dhe siguri; -

4 (kater) punonjës të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaEÄAN, Cisco ose ekuivalente”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Aftësia teknike dhe profesionale”, të modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve hardëare dhe softëare objekt-kontratë, duhet të disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës, të diplomuar në një nga porfilet e IT, **ose ekuivalente**, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë
- 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel experti në rrjete dhe siguri
- 4 (katër) punonjës të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaEÄAN, Cisco ose ekuivalente.
- 2 (dy) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentet në origjinal ose kopje të noterizuara për punonjësit e mësipërm, dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë e arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha degët e informatikës, shkencave kompjuterike, teknologjisë së informacionit, **ose ekuivalente**.
- Certifikatat/Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituara nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës, për secilin specialist të kualifikuar.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten 3 (tre) muajt e fundit ne te cilat stafi i siperpermendur duhet te figuroje.

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 1/a në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.1.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” d.o.o ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 27.01.2025 ndërmjetë shoqërisë “Verso” SHPK & “Verso Altima D.o.o. Qellimi i kësaj kontrate është të sanksionojë këtë marrëveshje ndërmjetë dy shoqërive të mësipërme përmes përfaqësuesve ligjorë të tyre, për krijimin e bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit që zhvillon autoritetin kontraktor Albpetrol sh.a me objekt me objekt: “*Implementimi i Smart Solution LoRaËAN ne infrastrukturen naftenxjeresë te Albpetrol sh.a. per periudhe 2 vjecare*” dhe me Nr. REF-34932-12-30-2024. Në nenin 4 të kontratës palët kanë rënë dakort që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e objektit të jetë si më poshtë, shoqëria “Verso” SHPK do të kontribuojë në masën 63.9% në këtë pjesëmarrje duke marrë persipër të realizojë zërat si: 1- *Antenat LoRaËan (Furnizim, Instalim)*; 2- *Konfigurim i Platformës Inteligjente Smart*; 3- *Licensat për Platformën Inteligjente/Smart (për 300 sensorë)*; 4- *Konfigurimi i Platformës së Serverit të rrjetit*; 5- *Licensat për Platformën e Serverit të rrjetit (për 10 antena)*; 6- *Trajnim i përdoruesve të platformës*; 7- *Mirëmbajtje*. Ndërsa shoqëria “Verso Altima” D. O.O do të kontribuojë në masën 36.1 % në këtë pjesëmarrje duke marrë persipër të realizojë zërat konkretisht si 1- *Sensorë inteligjente të vëllimit (furnizim, instalim, konfigurim)*; 2- *Pajisje inteligjente e menaxhimit të energjisë (furnizim, instalim dhe konfigurim)*.

2- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Verso” SHPK. Në Pjesën III: “*Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, gërma “B”: “*DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate*” operatori ekonomik “Verso” SHPK deklaroi:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve: 10 punonjës Profili i punonjësve: Ing. IT, rrjeti, ekonomiste Sokol Bani, diplomuar ne universitetin e Tiranës per informatikan, date 29.06.2006 I Certifikar ne nivel profesional nga kompania "Certifed Wireless network Professionals " (CWNP) per projektimin e rrjetave me vale, me ID nr. 824690 Makineri e mjete Po ☐ Jo ☒ Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri <u>Tatjana Tatjana</u> SKUKA Firma  Vula  Data e dorëzimit të deklaratës 10.02.2025	

Ju lutemi sigurohuni që:

3- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Verso Altimë” D.o.o. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” operatori ekonomik “Verso Altimë” D.o.o deklaron:

In the capacity of the economic operator, I declare under my full responsibility that: I have the necessary employees as well as the means and machinery for the execution of the contract, as defined in the tender documents, and I prove this with the relevant documentation, which I will present in original or notary copies if I win, or if I am required to clarify from the contracting authority/entity.	Employee Yes ☒ No ☐ If yes, the number of employees: 133 employees: It, finance, marketing, lawyers etc Employee Profile: It, finance, marketing, lawyers etc Drazen Kedmenec graduated on Multimedia content transmission in virtual private networks Master of Science - Certified by Cisco at expert level in networking and security (Cisco Certified Internetwork Expert (CCIE) Security) on 23.08.2018 Kresimir Petrovic graduated on bachelor of computing - Certified by Cisco at expert level in networking and security (Cisco Certified Internetwork Expert (CCIE) Security) on 29.11.2018 Vedran Kedmenec graduated on Electrical Engineering specialized in Videosignal Transmission by Application of Universal Access Network - Certified by Cisco at expert level in networking and security (Cisco Certified Internetwork Expert (CCIE) Security) on 13.12.2019 Jerko Susko , graduated on Electrical Engineering major in Telecommunication and informatics - Certified by Cisco on a professional level for Networking Cisco Certified Network Professional Enterprise 25.03.2004(CCNP) Enterprise - Certified by Cisco on a professional level for Networking Cisco Certified Network Professional Routing and Switching 25.03.2004 (CCNP) Routing and Switching
---	--

	Josko Udiljak graduated on bachelor of science in mathematics • Certified by Cisco on a professional level for Networking and Security (Certified on Cisco Certified Network Professional CCNP Security) on 19.09.2019 Danijel Cerovecki graduated on bachelor of science in electrical engineering major in Radio Communication and Professional Electronics. • Certified by Cisco on a professional level for Networking and Security (Cisco Certified Network Professional CCNP Security) on 05.04.2011 Denis Tensek graduated on bachelor of Engineering in Information Technology (IT) • Certified by Cisco on a Basic level for Networking (Cisco Certified Network Associate (CCNA)) on 19.09.2018 Nenad Kopic graduated on Mechanical Engineering on production engineering • Certified by Axelos in information technology services management with ITIL foundation Certificate in IT Service Management on 04.06.2019 Ivan Grgosevic graduated in Military Engineer at • Certified by Axelos in information technology services management with ITIL foundation Certificate in IT Service Management on 25.09.2024 Andrija Gebert, graduated at Faculty of electrical engineering Osijek • Certified by Project Management Institute at the professional level, for project management with certificate Project Management Professional on 20.04.2017
--	--

	• Certified by Axelos in information technology services management with ITIL version 3 Foundation Examination <u>Machinery and tools</u> Yes ☐ No ☐ If yes, you should be listed with specific data:
Name, Surname  GERENCIR Firm  VERSO ALTIMA Vula  VERSO ALTIMA d.o.o. Hrvatske 30A, HR-10010 Zagreb Croatia Date of submission of declaration 10.02.2025	

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë. 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.7. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.8. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit..

III.1.9. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

III.1.10. Në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.11. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.***

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërket të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i)

operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kanë dorëzuar formularin e tyre përmbledhës të vetëdeklarimit, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, kanë plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht kanë deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.5, të dokumenteve të tenderit. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu, nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Autoriteti kontraktor Albpetrol SHA, nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjën “h” pika 2 e nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të

*treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon :[...]h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti, për arritjen në një përfundim të saktë, që operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson këtë kriter, por është mjaftuar vetëm nga informacioni i pasqyruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, aq më tepër që njëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues është operator i huaj, dhe si i tillë profilet e studimit mund të jenë të ndryshme nga ato të parashikuara në Shtetin Shqipëtar, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të bëntë një verifikim të thelluar në lidhje me profilet e punonjesve përpara se të arrijnë në konkluzionet se këta punojës nuk janë të profilit të IT apo ekuivalent. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, objekt - ankimimi, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike.** Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.*

III.1.13. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.5 për disponimin e stafit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve hardëare dhe softëare objekt-kontratë, duhet të disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës, të diplomuar në një nga profilet e IT, ose ekuivalente, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për çertifikime profesionale, si më poshtë: - 1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë; - 2 (dy) punonjës të çertifikuar në nivel experti në rrjeta dhe siguri; - 4 (katër) punonjës të çertifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaEAN, Cisco ose ekuivalente; - 2 (dy) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit; - 1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve. Nisur nga arsyet e skualifikimit, për plotësimin e këtij kriteri, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.o.o kanë dorëzuar, në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), secili Formularin e tyre Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” të tyre, shkronja B – Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, kanë deklaruar se disponojnë konkretisht operatori “Verso” SHPK deklaron se disponon 10 punonjës në total dhe profilin e

punonjesit, ndërsa operatori “Verso Altima” D.o.o deklaron se disponon 133 punonjës dhe profilin e punonjësit. Referuar deklarimeve të bëra nga ky bashkim operatorësh në formularët përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe kontratës së bashkëpunimit në të cilën kanë ndarë përqindjen që do të marrë përsipër secili anëtarë rezulton se e përmbushin kriterin e disponimit të punonjësve në rraport me përqindjen e marrë përsipër nga secili anëtar, akoma më tej vetë autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.5 ka përcaktuar se një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata, pra edhe në këtë rast autoriteti kontraktor do të duhej ti kërkontë dokumentacion mbi vërtetueshmërinë e deklarimeve në formularin përmbledhës përse i përkt stafit në mënyrë që të arrinte në konkluzione të sakta në lidhje me përmbushjen ose jo të kriterit 2.3.5. Referuar kriterit të sipërcituar, si dhe nenit 26 të VKM 285, dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar disponimin e numrit të punonjësve dhe profileve në përputhje me kriterin e kualifikimit, duke përmbushur dhe tejkaluar në këtë mënyrë stafin e kërkuara. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me arsyen e mësipërme të skualifikimit të ketë kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 6 të nenit 26 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,** pavarësisht që vetë autoriteti në përfundim të kriterit 2.3.5 ka përcaktuar, se në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën “h” dhe “i” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për këtë arsye, për sa kohë, nga vetë autoriteti kontraktor është specifikuar në dokumentet standarde të tenderit, se ky kriter do të quhet i përmbushur me dorëzimin e shtojcës 8, pra Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe akoma më tej nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj dhe VKM si më sipër cituar, atëherë skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, vlen të theksojmë, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në kriterin e veçantë të kualifikimit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për bashkimin e operatorëve ekonomikë në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura

nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtyre kapaciteteve, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të ketë bërë një hetim, verifikim apo ti ketë kërkuar dokumentacion për punonjësit bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues sikurse e parashikon ligji. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,** si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë autoriteti kontraktor është mbështetur mbi një kriter i cili është vendosur në tejkallim të parashikimeve të ligjit të prokurimit publik, pasi ligji dhe aktet nënligjore qartësisht normojnë mënyrën se si do të përmbushet ky kriter, përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit miratuar me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik. Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022, protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].

KPP vlerëson, se ligjvënësi ka parashikuar dy momente të përcaktimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”. Momenti i parë lidhet me kriteret e kualifikimit, si përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësinë teknike dhe

profesionale., në të cilat ligjvënësi i ka lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor për përcaktimin e tyre, diskrecion, i cili edhe në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, nuk mund të tejkalojë kufijtë e vendosur nga ligji dhe konkretisht, atë të vendosur në nenin 77 të ligjit për prokurimin publik, pra të jenë në proporcion me natyrën, volumin dhe përmasat e kontratës, si edhe të mos jenë diskriminuese. Së dyti, është grupi i kriterëve të kualifikimit të cilat janë të shprehura qartësisht në ligj ose në akt nënligjor dhe që janë detyruese për të gjithë autoritetet kontraktore.

Pra, elementët që janë të domosdoshme për të përmbushur fazën e parë të vetëdeklarimit në drejtim të disponueshmërisë së stafit teknik dhe mjeteve në rastin konkret, është vetëm plotësimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke dhënë informacionin e nevojshëm sipas edhe komunikimit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, i krijuar në përputhje me Direktivën 89/665, datë 21 dhjetor 1989, krijuar me ligj për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Në zbatim të nenit 24 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” në të cilin përcaktohet se: “*Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktorit*”, Komisioni thekson se qëndrueshmëria në vendimmarrje tashmë e konsoliduar prej tij, është një prej elementeve thelbësore të shqyrtimit të ankesave, për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mbi të gjitha të sigurisë juridike, të cilat KPP gjatë kryerjes së detyrave të saj zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor të prokurimeve publike. Konkretisht Komisioni i Prokurimit Publik, në vendimmarrjen e tij ka krijuar një qëndrueshmëri edhe për sa i përket rastit konkret, arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, mjafton të citojmë këtu vendimet nr. 1148/2023, datë 14.11.2023, nr. 1256/2023, datë 05.12.2023, nr. 1338/2023, datë 20.12.2023, nr. 1100/2023, datë 30.10.2023, nr. 1119/2023, datë 02.11.2023, nr. 711/2022, datë 25.07.2022, nr. 1018/2021, datë 20.12.2021, vendime në të cilat Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin konkret, pra duke konsoliduar vendimmarrjen e tij për raste të ngjashme, vendime këto jo vetëm që janë të publikuara në faqen e tij zyrtare dhe në buletinet mujore, por gjenden dhe në një seksion të posaçëm të faqes zyrtare të Komisionit Prokurimit Publik në seksion Praktika Gjyqësore dhe Vendime mbi Interpretimin e dispozitave të zbatueshme për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, të cilat iu drejtohen jo vetëm operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të interesuara, por edhe autoriteteve kontraktore.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.o.o qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.o.o për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34932-12-30-2024, me objekt: “Implementimi i Smart Solution LoRaEÄN ne infrastrukturen naftenxjeresë të Albpetrol sh.a. për periudhë 2 vjecare”, me fond limit 78,804,667 (shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 806,021 (tetëqind e gjashtë mijë e njëzet e një) Euro pa tvsh me kursin e kembimit të datës 30.12.2024, zhvilluar më datë 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.o.o si dhe të korrigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Verso” SHPK & “Verso Altima” D.o.o” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

